



## KOMUNA E PRISHTINËS

### RAPORT MUJOR

Drejtoria	Drejtoria e Rinisë dhe Sportit (DRS)
Periudha raportuese	Gusht, 2020
Emri dhe mbiemri i raportuesit	Fitim Rexha

#### 1. PËRMBLEDHJE - Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes/ecurisë së punës në drejtorinë tuaj për muajin raportues.

Pavarësisht gjendjes ekzistuese të pandemisë, DRS ka vazhduar punën dhe përkushtimin në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi konform parashikimeve, gjithnjë duke respektuar masat e duhura të përcaktuara për mbrojtjen e shëndetit nga COVID - 19.

Drejtoria e Rinisë dhe Sportit ka pranuar 2 lëndë gjatë muajit gusht, një është miratuar dhe një është në proces. Kërkesa e miratuar ka qenë për regjistrimin e klubit atletik "Green Team", ndërsa në proces është kërkesa e klubit atletik "Prishtina".

*Të dhëna statistikore për Drejtorinë e Rinisë dhe Sportit:*

<i>Lëndët e pranuar, gusht 2020</i>	<b>Në Proces</b>	<b>Të miratuara vendime, pëlqime</b>	<b>Të refuzuara</b>	<b>Lëndët dhe Raportet nga Klubet Sportive</b>
<b>2</b>	1	1	00	00

#### 2. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA - Listoni aktivitetet për muajin raportues, të parapara sipas planprogramit të Komunës për drejtorinë tuaj.

DRS, gjatë muajit gusht ka bërë procedimin e ankesave për subvencione në Komisionin për Ankesa. Pas shqyrtimit të tyre, Komisioni ka vendosur që 15 të aprovohen dhe 9 të refuzohen.

Lëndët e proceduara për në Komisionin e Ankesave:

<i>Data</i>	<b>Numri i lëndëve</b>	<b>Fusha e veprimtarisë</b>
<b>12.08.2020</b>	4	Sport
<b>12.08.2020</b>	8	Rini
<b>12.08.2020</b>	3	Individual

Po ashtu DRS, gjatë muajit gusht është angazhuar në realizimin e planitbuxhetorë të DRS-së:

Kodi 49799 është përgatitur për dorëzim për procedim të mëtutjeshme.

Kodi 49808 është dorëzuar për procedim të mëtutjeshëm.

Kodet që kanë të bëjnë me fushat sportive dhe këndet e lodrave, janë bërë paramasat për ndërtimin e katër terreneve sportive, në pesë lokacione të ndryshme të Komunës, siç përshkruhet në kodet e mëposhtme, dhe ka mbetur vetëm edhe finalizimi i paramasave për dorëzimin në Prokurim.

KODI	KAPITALET	BUXHETI	ALOKIM ET	MBETJA
49814	Ndërtimi i fushës sportive të SHFMU "Ilmi Rakovica"	50,000.00	10,000.00	50,000.00
49784	Ndërtimi i Sallës multifunkionale në komunën e Prishtinës	1,110,000.00		1,110,000.00
89412	Ndërtimi i fushave sportive në komunën e Prishtine	250,000.00	50,000.00	250,000.00
49791	Shtigje për ecje dhe vrapim, shënimi dhe infrastruktura të ngjashëm me shtegun	140,000.00	50,000.00	140,000.00
49799	Zhvillimin i aktiviteteve sportive dhe rinore: kupa, medalje etj.	50,000.00	10,000.00	50,000.00
49808	Shënimi i fushave sportive dhe këndeve të lodrave me tabela njoftuese	5,000.00		5,000.00
	<b>Gjithsej</b>	<b>1,605,000.00</b>	<b>120,000.00</b>	<b>1,605,000.00</b>

**3. AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA - Listoni dhe shpjegoni aktivitetet e implementuara gjatë periudhës raportuese nga drejtoria juaj, duke përfshirë edhe aktivitetet që janë në implementim e sipër. Theksoni të arriturat e drejtorisë:**

- Përfundimi i lëndëve me dokumente konkrete;
- Bashkëpunimi me Zyrën për Investime Kapitale dhe Zyrën për Rigjenerim Urban, lidhur me ndërtimin e fushave sportive dhe këndeve të lodrave;

- Fusha sportive në lagjen “Emshiri”;
  - Fusha sportive në SHMU “Ilmi Rakovica”;
  - Fusha sportive në fshatin Llukar;
  - Fusha sportive në fshatin Bardhosh;
  - Këndi i lodrave në lagjen “Emshiri”;
  - Këndi i lodrave në lagjen “Dardania”;
  - Këndi i lodrave në Hajvali.
- Takimet e rregullta të zyrtarëve shqyrtues me grupin profesional - Kolegjiumin për lëndë konkrete;
  - Takime të shumta me qytetarë dhe klube të sportit dhe organizata rinore për konsultime;
  - Takim me zyrtarët e Drejtorisë dhe ekspertë të jashtëm për planifikimin e buxhetit të Drejtorisë për vitin 2021.
  - Takim me OJQ “QPSM”, për sqarim të mbajtës së aktiviteteve të planifikuara me fëmijët me Sindrom Down;
  - Përgjigje në kërkesa të ndryshme sa i përket punës së Drejtorisë.

#### ***4. AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR - Të përshkruhen në detaje aktivitetet që janë në implementim e sipër nga drejtoria juaj për muajin raportues.***

- Është duke vazhduar projekti (110,991.30) për ndërtimin e dy terreneve sportive:
  - “Lagja e Universitetit” - Terren sportiv për tenis, i përfunduar mbi 30%. Gjatë implementimit kanë hasur në probleme me kablo të rrymës nëntokësore, të cilat nuk po largohen me kohë nga përgjegjësit e KEDS-it;
  - Lagja “Arbëria” - Terreni sportiv për futboll, basketboll dhe volejball është përfunduar. Por, Drejtoria e Sportit ka ngritur disa probleme lidhur me këtë fushë, për çka edhe i ka dorëzuar vërejtjet tek menaxheri i kontratës. Shkaqet e vonesave kanë qenë moti dhe pandemia, por ndoshta edhe një papërgjegjësi e menaxherëve të projektit.
- Po punohet që sa më shpejt të kryhen projektet dhe paramasat, me qëllim të fillojmë procedurave të tenderimit të fushave sportive:
  - Fusha sportive në lagjen “Emshiri”;
  - Fusha sportive në SHMU “Ilmi Rakovica”;
  - Fusha sportive në fshatin Llukar;
  - Fusha sportive në fshatin Bardhosh;
  - Këndi i lodrave në lagjen “Emshiri”;
  - Këndi i lodrave në lagjen “Dardania”;
  - Këndi i lodrave në Hajvali.

#### ***4.1.2. Buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese.***

Edhe pse raportet tregojnë se DRS nuk ka buxhet të shpenzuar, i tërë buxheti i DRS-së është në procedurë e sipër, duke filluar nga subvencionet, ndërtimi i fushave sportive, këndeve të lodrave, si dhe përfundimi i projekteve.

#### **4.1.3 Takimet me palë**

Kanë vazhduar takimet me palë, të martave dhe të enjteve, me përjashtime edhe ditëve të tjera sipas nevojës. Gjithmonë duke zbatuar rekomandimet nga Komuna, IKSHP dhe institucionet tjera relevante.

#### **5. Diskutime publike/takimet me qytetarë**

*Takim me qytetarët e lagjeve "Dardania", "Lakërishta", "Emshiri" dhe grupe të ndryshme nga fusha e Sportit dhe Rinisë.*

#### **6. Takime të tjera**

- Takim në mes të DRS dhe DK;
- Takim me DSHP dhe DP.

**7. SFIDAT - Nëse gjatë implementimit të planeve është hasur në vështirësi të ndryshme, psh. pengesa brenda drejtorisë, komunës, apo institucioneve të ndryshme, ju lutëm shpjegoni në këtë hapësirë.**

Sfidë për DRS mbetet edhe më tutje çështja e implementimit të projekteve në realizim e sipër, si dhe atyre të cilat janë planifikuar. DRS nuk është e kënaqur me menaxherët e projekteve, si dhe me pjesën kur projektet dorëzohen në Prokurim.

Sfidë për DRS mbetet krijimi i një plani të veprimit për Sport dhe Rini.

**8. REKOMANDIME - Shënoni rekomandime rreth përmirësimit të mbarëvajtjes së proceseve, nëse keni, dhe nevojave të Drejtorisë për të gjitha aspektet, p.sh. trajnime të punëtoreve, furnizim me pajisje shtesë etj.**

- Të mundësohen trajnime ose vizita zyrtare të stafit sa i përket procedurës së vlerësimit dhe menaxhimit kontratave.

**9. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR MUAJIN PASUES - Listoni aktivitetet e planifikuara për drejtorinë tuaj për muajin pasues:**

- Vazhdimi me shqyrtimin e lëndëve (aprovim, refuzim);
- Procedimi i lëndëve, sipas afatit kohor të paraparë me ligj;
- Analizat dhe listimi i aktiviteteve të nevojshme përgatitore për sistemin online për klubet/OJQ e Prishtinës;
- Konsultime me palë në lidhje me projektet;
- Aktivitete rreth avancimit të shërbimit të informimit të Klubeve/OJQ-ve për procedurat e aplikimit dhe regjistrimit në Komunë;
- Dorëzimi i projekteve për terrenet sportive dhe shtigjet për vrapim, në Prokurim për procedim të mëtutjeshëm.